



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA PROFESIONALE ELBASAN

Nr. 68/2 prot.

Data 03.10.2024

Lënda: Njoftim për vend i lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.5.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit":

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin mësimdhënës i kulturës profesionale **me kohë të pjesshme**:  
Pozicioni: mësimdhënës i teorisë profesionale drejtim tekstil konfeksione 1- mësimdhënës me 11 orë

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon

- të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

## 2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

11.10.2024.

**DREJTOR**  
**Leonidha Haxhinikolla**

